

## STATUTI I SHOQËRISË “ASL SOLAR ENERGY” SH.P.K

Në mbështetje të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar si dhe të gjithë Legjislacionit Shqiptar në fuqi;

Sot, në Tiranë, me datë 03.06.2022 (*dymijë e njëzetë e dy*), Ortaku i vetëm i poshtëshënuar themeloi Shoqërinë “ASL SOLAR ENERGY” Sh.p.k, e cila do të organizohet dhe do të drejtohet sipas këtij Statuti të trajtuar në të njëjtën dokument me Aktin e Themelimit.

Ortaku i vetëm i shoqërisë është:

**Shoqëria “ASL” Sh.p.k**, regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L81310025T, me seli në adresën: Njësia Administrative Nr. 3, Rruga “Kongresi i Manastirit”, Zona Kadastrale Nr. 8140, Nr. Pasurie 3/967, përfaqësuar nga ortaku i vetëm i shoqërisë **Z. Fatmir Isufaj**, atësia Shyqyri, lindur në Skrapar më 13.05.1975 dhe banues në Linzë, Tiranë, i pajisur me letërnjoftimin me Nr. Personal H50513171R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që zotëron 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themletar të Shoqërisë “ASL” Sh.p.k, sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm Nr. 11, datë 03.06.2022.

### KAPITULLI DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

##### Themelimi, Forma dhe Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Krijohet Shoqëria “ASL SOLAR ENERGY” Sh.p.k.
- 1.2 Shoqëria është Person Juridik Privat dhe një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.
- 1.3 Shoqëria do të paraqitet me emërtimin tregtar “ASL SOLAR ENERGY” Sh.p.k.
- 1.4 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.5 Shoqëria do të ketë vulën dhe logon e saj identifikuese, në formën e caktuar nga Ortaku i vetëm i shoqërisë.

#### Neni 2

##### Themeluesit

- 2.1 Shoqëria është themeluar nga Ortaku i vetëm i saj:

**Shoqëria “ASL” Sh.p.k**, regjistruar si person juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L81310025T, me seli në adresën: Njësia Administrative Nr. 3, Rruga “Kongresi i Manastirit”, Zona Kadastrale Nr. 8140, Nr. Pasurie 3/967, përfaqësuar nga ortaku i vetëm i shoqërisë **Z. Fatmir Isufaj**, atësia Shyqyri, lindur në Skrapar më 13.05.1975 dhe banues në Linzë, Tiranë, i pajisur me letërnjoftimin me Nr. Personal H50513171R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që zotëron 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themletar të Shoqërisë “ASL” Sh.p.k.

### Neni 3

#### Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

3.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin tregtar aktual shqiptar do të jetë:

*“Instalim dhe ndërtim i impianteve energjitike nga burime të rinovueshme nga dielli, era, uji etj. Tregtim i energjisë nga burime të rinovueshme. Import - eksport, projektim, instalim, supervizim, mirëmbajtje, auditim energjistik dhe tregti të sistemeve të paneleve diellore, fotovoltaike dhe atyre termodinamike. Import - eksport mallra e paisje të teknologjisë në fushën e energjistikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen, dhe menaxhimin e centralit me impjante Fotovoltaike, termodinamike e forma të tjera të prodhimit të energjisë të ushqyera nga burime të ndryshme si: hidroelektrike, diellore, me erë, biomasa etj. Konsulencë në çdo aktivitet që lidhet me fushën e energjisë.”*

3.2 Shoqëria brenda hapësirave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtëpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të reja, krijimin e sipërmarrjeve të reja dhe pjesëmarrjen në sipërmarrje të tjera, si brenda dhe jashtë vendit.

3.3 Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përmbushjen e veprimtarisë të saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### Neni 4

#### Selia e shoqërisë dhe degët

4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë në adresën: Njësia Administrative Nr. 3, Rruga “Kongresi i Manastirit”, Zona Kadastrale Nr. 8140, Nr. Pasurie 3/967.

4.2 Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendim të Ortakut të vetëm të Shoqërisë.

4.3 Shoqëria ka të drejtë të operojë me zyra, filiale, degë apo agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë apo dhe jashtë vendit.

4.4 Zyrat, filialet, degët apo agjensitë krijohen me Vendim të Ortakut të vetëm të Shoqërisë, i cili organizon punën dhe emëron organet drejtuese dhe përfaqësuesit e tyre ligjor.

### Neni 5

#### Kohëzgjatja e shoqërisë

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë “ASL SOLAR ENERGY” Sh.p.k është e pakufizuar dhe fillon në momentin e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

5.2 Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë.

5.3 Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë.

**KAPITULLI II  
KAPITALI THEMELTAR**

**Neni 6**

**Kapitali Themeltar**

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 lekë (Njëqind lekë)** dhe përbëhet nga **1 (një) kuotë**. Kontributet e Ortakut të vetëm përbëjnë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
- 6.2 Pronësia mbi kapitalin themeltar të shoqërisë është **100% për Shoqërinë “ASL” Sh.p.k.**
- 6.3 Kapitali themeltar është shlyer plotësisht nga ortaku i vetëm përpara regjistrimit të kësaj shoqërie.
- 6.4 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**Neni 7**

**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 7.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së Administratorit.
- 7.2 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakut të vetëm, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

**Neni 8**

**Transferimi i kapitalit**

- 8.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 8.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**

**ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

**Neni 9**

**Organi Vendimmarrës**

- 9.1 Asambleja e Ortakut të vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 9.2 Asambleja e Ortakut të vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 9.3 Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të vetëm është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;

- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 9.4 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një person i tretë.
- 9.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakut të vetëm në Asamblenë e Përgjithshme.
- 9.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 10

##### Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet ortakut të vetëm, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 10.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortaku i vetëm është dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 11

##### Kuorumi

- 11.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 11.2 Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 11.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 12**

**Marrja e vendimeve**

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakut të vetëm pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakut të vetëm pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - përcaktimin e shpërblimeve
  - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 12.3 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

**Neni 13**

**Përjashtimi nga e drejta e votës**

- 13.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 13.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

**KAPITULLI IV  
DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

**Neni 14**

**Administratori**

- 14.1 Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj:
- **Z. Eduart Liçi**, atësia Kriti, shtetas Shqiptar, lindur më 03.10.1977, në Toshkëz, Lushnjë dhe banues në Rrugën “Kujtim Laro”, Nd. 10, H. 1, Njësia Administrative Nr. 3, Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Letërnjoftim ID Nr. 033638033 dhe Nr. Personal H71003094L;
- 14.2 Administratori i shoqërisë emërohet me një afat 5 (pesë) vjeçar.
- 14.3 Administratori do të ketë të drejtë për rimbursimin e shpenzimeve të bëra prej tij për llogari të shoqërisë.

14.4 Kur administratori i shoqërisë rezulton i suksesshëm në punën e tij dhe në rezultatin financiar të kompanisë, atëherë Ortaku i vetëm i shoqërisë vendosin lidhur me shpërblimin që do t’i jepet atij në fund të vitit financiar.

#### Neni 15

##### Kompetencat e Administratorit

15.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

15.2 Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.;
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

15.3 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### KAPITULLI V

##### VITI FINANCIAR , BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMIT

#### Neni 16

##### Viti financiar

16.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 17**  
**Ekspertët**

- 17.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë-vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm.
- 17.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t’ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut të vetëm për t’i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**KREU VI**  
**PRISHJA -RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 18**  
**Prishja dhe likuidimi**

- 18.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në ëdo kohë :
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblese se Ortakut të vetëm;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin nr. 131/2015.
  - e) me vendim të gjykatës;
- 18.2 Në këtë rast Ortaku merr vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në ëdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.
- 18.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 18.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

**Neni 19**  
**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

- 19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakut të vetëm, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

- 20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.  
Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**

**Mosmarrëveshjet**

21.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

**Neni 22**

**Fitimi që shpërndahe**

22.1 Koha, mënyra dhe shuma e fitimit që shpërndahe vendoset rast pas rasti nga Ortaku i shoqërisë sipas raportit të administrimit në përputhje me këtë Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

**Neni 23**

**Hyrja në fuqi**

23.1 Ky statut hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga Ortaku themelues i shoqërisë.

**ORTAKU I VETËM**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

\*\*\*ASL SOLAR ENERGY Sh.p.k \*\*\*

Shoqëria “ASL” Sh.p.k  
Ortaku i vetëm  
Fatmir ISUFAJ

FATMIR ISUFAJ





\* \* \*

**VENDIM NR. 11**  
**I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKUT TË VETËM**  
**të Shoqërisë “ASL” Sh.p.k**

\* \* \*

Më datë **03.06.2022** (*dymijë e nëjzetë e dy*), në orën 10:00, e thirrur rregullisht sipas normave ligjore e të statutit është mbledhur, me thirrjen e parë, pranë selisë së Shoqërisë “ASL” Sh.p.k, me NIPT L81310025T, me zyra qendrore të shoqërisë në adresën: Njësia Administrative Nr. 3, Rruga “Kongresi i Manastirit”, Zona Kadastrale Nr. 8140, Nr. Pasurie 3/967 Tiranë, Shqipëri, Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm, për të diskutuar dhe vendosur rreth rendit të ditës në vijim:

**ÇËSHTJET E RENDIT TË DITËS:**

1. Miratimin e pjesëmarrjes e Shoqërisë “ASL” Sh.p.k, si Ortak i Vetëm Themelues, në themelimin e **Shoqërisë “ASL SOLAR ENERGY” Sh.p.k.**
2. Miratimin e kalimit të shumës prej **100 lek (njëqind lek)**, për shlyerjen e vlerës së kuotës së pjesëmarrjes së Shoqërisë “ASL” Sh.p.k si ortak i vetëm themelues, në kapitalin themeltar të Shoqërisë “ASL SOLAR ENERGY” Sh.p.k.
3. Caktimin e ortakut të vetëm të Shoqërisë “ASL” Sh.p.k, Z. Fatmir Isufaj, për nënshkrimin e Statutit të Shoqërisë “ASL SOLAR ENERGY” Sh.p.k, si ortaku i vetëm themelues i kësaj shoqërie.

**Në mbledhje është i pranishëm:**

**Z. Fatmir Isufaj**, atësia Shyqyri, lindur në Skrapar më 13.05.1975 dhe banues në Linzë, Tiranë, i pajisur me letërnjoftimin me Nr. Personal H50513171R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ortak i vetëm i shoqërisë që zotëron 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë “ASL” Sh.p.k.

*Në funksion të shqyrtimit të rendit të ditës, asambleja e ortakut të vetëm,*

**VËREN SE:**

Shoqëria “ASL” Sh.p.k në funksion të zhvillimit të aktivitetit të saj tregtar, nëpërmjet investimit në sektorin e energjitikës (pjesë e fushës së veprimtarisë së shoqërisë) ka vendosur të themelojë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar: “ASL SOLAR ENERGY” Sh.p.k, e cila do të ushtrojë aktivitetin e saj në fushën e instalimit dhe ndërtimit të impianteve energjitike nga burime të rinovueshme nga dielli, era, uji etj.

**Z. Fatmir Isufaj, ortak i vetëm i Shoqërisë “ASL” Sh.p.k miraton rendin e ditës dhe**  
**VENDOSIMË POSHTË:**

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Shoqërisë “ASL” Sh.p.k si Ortak të Vetëm Themelues, në themelimin e **Shoqërisë “ASL SOLAR ENERGY” Sh.p.k.**
2. Të miratojë kalimin e shumës prej **100 lek (njëqind lek)**, për shlyerjen e vlerës së kuotës së pjesëmarrjes së Shoqërisë “ASL” Sh.p.k si ortak i vetëm themelues, në kapitalin themeltar të Shoqërisë “ASL SOLAR ENERGY” Sh.p.k.

3. Te caktoje ortakun e vetem te Shoqerise ASL Sh.p.k, Z. Fatmir Isufaj, per nenshkrimin e Statutit te Shoqerise "ASL SOLAR ENERGY" Sh.p.k, si ortaku i vetem themelues i kesaj shoqerie.
4. Duke qene se nuk pati cheshtje te tjera ne rendin e ditës, mbledhja u mbyll.
5. Ky vendim hartohet ne 3 (tre) kopje ne vlerë ligjore te barabarte secila. Nje kopje e vendimit depozitohet pranë QKB-së.

*\*\*\*Lexohet, aprovohet, nenshkruhet\*\*\**

**\*\*\*ASAMBLEJA E ORTAKUT TË VETËM\*\*\***

**SHOQËRIA "ASL" SH.P.K**

*Ortaku i vetem*

**Z. FATMIR ISUFAJ**

FATMIR ISUFAJ

